

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA  
 GOVERNMENT OF KOSOVO  
 MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE  
 MINISTRY OF JUSTICE  
 Nr. Sh. Nr: 08-94/12  
 Data/Datumi/Date: 01/02/2021  
 Shtojcë/Dodaci/Annex: 02020  
 PRISHTINË/A



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
 Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of  
 Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.06/2017

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Adnan Isufi,  
 kryes, Diellza Hoxha dhe Myjesere Mujku, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj  
 përmbarueses private, si organ përmbarues, e emëruar nga Ministria e  
 Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës  
 Themelore e dyshuar për shkelje disiplinore lidhur me veprimet përmbarimore në  
 lëndën përmbarimore, P. nr 166/16, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike me datën  
 25.01.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-06/2017, datë 11.12.2020, dhe ankesa nga Institucioni Finaciar, të datës 12.06.2017, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesja Private, nuk është përgjegjëse për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr 166/16.

**A r s y e t i m**

Me datën 22.06.2017, Ministria e Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur propozim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarueses private si organ përmbarues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore, sepse ka tejkalluar autorizimet e saj dhe gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të saj, nuk i është përmbajtur ligjit, siç kërkohet, me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën përmbarimore P nr. 166/16. Propozimi është paraqitur mbi bazën e ankesës së paraqitur nga pala ankuuese- Institucioni Finaciar

Bank, ku ndër të tjera është theksuar që përbaruesja private, në lëndën gjegjëse përbarimore, ka lëshuar urdhër përbarimor në bazë të propozimit për lejimin e ekzekutimit duke u bazuar në titullin përbarimor, aktgjykimin e gjykatës themelore në Prishtinë C.nr 3295/12 e që ka të bëjë me kompenzimin nga marrëdhënia e punës, dhe në këtë mënyrë ka bërë shkeljet e pretenduara disiplinore.

Me datën 22.12.2016, Komisioni Disiplinor kishte nxjerr vendim me të cilin përbaruesja private, subjekt i procedurës disiplinore, është gjetur jo përgjegjëse për shkeljet e pretenduara disiplinore. Mes tjerash Komisioni Disiplinor kishte theksuar që kishte pasur një kontroll gjyqësor mbi urdhërin përbarimor. Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin PPP.nr 526/16 të dt 30.09.2016 e ka refuzuar prapësimin e debitorit- Institucionit Financiar të Komisionit Disiplinor të lënë në fuqi urdhërin për lejimin e përbarimit. Tutje, Komisioni Disiplinor kishte theksuar se bazuar në faktin se çështja e kompetencës lëndore vlerësohet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*), rezulton se gjykata në fjalë ka mbajtur qëndrimin se ekzekutimi i aktgjykimit C. nr 3295/12 bie pikërisht në kompetencës e përbarueses private dhe se nuk është krijuar ndonjë praktikë gjyqësore që për rastet e tilla apo të ngjajshme, procedura përbarimore të zhvillohet nga gjykata.

Me datën 04.11.2020, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.nr 1785/15, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit- Institucionit Financiar të Komisionit Disiplinor dhe ka anuluar vendimin e Komisionit Disiplinor dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim. Gjykata kishte ardhur në përfundim se vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërtëhënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Aktgjykimi thekson se seanca për këshillim dhe votim i referohet datës 22.12.2016 kurse propozimi për fillimin e procedurës disiplinore mban datën 22.06.2017 dhe se në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare.

Pas pranimit të Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datën 11.12.2020, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesionet e Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për ri-fillimin e procedurës disiplinore ndaj përbarueses private të Komisionit Disiplinor si organ përbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me veprimet përbarimore në lëndën P. nr 166/16.

Përbaruesja private të Komisionit Disiplinor në përgjigjen e saj thekson se lidhur me këtë rast me vendimin numër 06/2017, date 22.12.2016, Komisioni Disiplinor kishte gjetur se ajo nuk është përgjegjëse për shkeljet e pretenduara disiplinore. Sa i përket veprimeve të tjera juridike të cilat janë ndërmarr nga ana e debitorit tutje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ajo thekson se nuk është njoftuar kurse Aktgjykimin e ka pranuar nga Ministria. Shton se kjo lëndë mbi të gjitha është parashkruar por edhe sikur të ishte ndryshe, ajo konsideron se ankesa e palës debitore lidhur me bazën të cilën pretendohet për tejkallim të kompetencave nuk është e bazuar. Përbaruesja private thekson se lënda përbarimore në fjalë ishte inicuar në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm C.nr.3295/12, i datës 13.07.2016, e me të cilin ishte aprovuar kërkesa padia e paditësit I të Komisionit Disiplinor. Pala e paditur- Komisioni Disiplinor bank ishte detyruar që paditësit t'i kompensoj në emër të kamates shtuarën e caktuar si per nje vit, dhe deponuara për një vit pa destinim për periudhën 28.01.2008 e deri 12.11.2008. Padia nuk ka qenë nga kontesti i marrëdhënies së punës, siç

pretendohet, por e njëjta ka të bëjë me borgjin rrjedhimisht kompenzimin e kamatës së pa paguar të borgjit kryesor të cilin ka paguar. Përmbauesja private thekson që, në rastin konkret, pala ka paraqitur prapësim, e cila ishte refuzuar. Paraprakisht debitori kishte kërkuar edhe përjashtimin e përmbauesit privat, me ç'rast gjykata me aktvendimin e saj e ka refuzuar kërkesën e debitorit, tutje edhe ankesën e debitorit parashtruar në gjykatën e apelit. Gjykata e Apelit me aktvendimin saj Ac.nr.3672/17, e refuzon ankesën ndërkaq aktvendimin e gjykatës themelore e vërteton, prandaj janë shterur gjitha mjetet juridike. Shton se Gjykata themelore në Prishtinë, në aktgjykimin e saj A.nr.1785/17, thekson se arsyetimi i vendimit të Komisionit Disiplinor nuk është arsyetuar mirë, por në njoftimin për fillimin e procedurës vendimi është vetëm dy faqe, që do të thotë se pjesa e arsyetimit mungon. Prandaj duhet sqaruar nëse gjykata e ka pas vendimin e plotë me rastin e marrjes së Aktgjykimit.

Me datën 25.08.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese -Institucionit Financiar si dhe përmbauesja private,

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaueses private duke theksuar se bazuar në ankesën e parashtruar nga pala ankuese e njëjta ka bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbaimore në lëndën P.nr 166/16 duke shkelur ligjin dhe tejkualuar autorizimet ligjore. Po ashtu edhe përfaqësuesi i palës ankuese- Institucionit Financiar I Bank ka ngelur pranë pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim dhe të paraqitura gjatë seancës dëgjimore.

Pas paraqitjes së pretendimeve nga palët, Komisioni Disiplinor gjatë procedurës së provave ka administruar provat në vijim: Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A. Nr 1785/17, të datës 04.11.2020; vendimin e datës 27.09.2017, nr 08-25533/11; urdhr për transfere të datës 13.10.2016; ankesën e datës 12.06.2017, nr 08-25533; ankesën PPP. Nr 526/16; Vërtetimin mbi pranimin e pagesës; Ankesën P. Nr 166/16; vërtetimin mbi pranimin, 2301856; Propozimin për lejimin e ekzekutimit të datës 09.06.2016; Urdhrin, nr. 166/16, të datës 13.06.2016; Shkresa e datës 15.03.2019; Aktgjykimi i datës 13.05.2013; Prapësimi, P.nr 166/16; Aktvendimi i datës 12.10.2016; Komunikimi elektronik i datës 13.10.2016 dhe i datës 14.10.2016; kërkesa për përjashtim të përmbauesit privat i datës 13.10.2016; parashtrësë e datës 14.10.2016; Aktvendimi i datës 06.06.2017; Aktvendimi i datës 21.03.2016; Kundërshtimi i datës 24.07.2017; Aktvendimi i datës 30.09.2016; shkresa e datës 22.06.2017; Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore nr 06/2017; procesverbali i datës 07.09.2017; njoftimi i datës 03.07.2017; komunikimi elektronik i datës 19.09.2017; ankesa e datës 12.06.2017; urdhr për transferim i datës 08.06.2017; ekspertiza financiare e datës 07.06.2017 dhe konkluzioni i datës 14.10.2016.

Komisioni me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se gjendja faktike është

vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë se përmbauesja private nuk ka kryer veprën e pretenduar disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen më rëndësi të thekson fillimisht se bazuar në shkresat e lëndës nuk është e qartë nëse Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kishte apo jo në dispozicion Vendimin e plotë të Komisionit Disiplinor me rastin e vendosjes sipas padisë së palës paditëse ndaj atij vendimi. Në kopjen e vendimit para këtij Komisioni Disiplinor mungonte një faqe dhe me kërkesë të Komisionit, Ministria e Drejtësisë ka ofruar kopjen e plotë të atij vendimi. Sidoqoftë, duke vepruar mbi bazën e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin çështja disiplinore ndaj përmbaueses private është kthyer në rivendosje, Komisioni Disiplinor ka dëgjuar pretendimet e palëve dhe pas analizimit të provave ka ardhur në të njëjtin përfundim sikurse edhe në vendimin e mëparshëm të Komisionit.

Çështja themelore para këtij Komisioni është nëse përmbauesja private kishte kompetencë të vendos në çështjen konkrete përmbaimore. Pala ankuese pretendon që përmbauesja private, në lëndën gjegjëse përmbaimore, ka lëshuar urdhër përmbaimitor në bazë të propozimit për lejimin e ekzekutimit duke u bazuar në titullin përmbaimitor, aktgjykimin e gjykatës themelore në Prishtinë C.nr 3295/12 e që ka të bëjë me kompenzimin nga marrëdhënia e punës, dhe në këtë mënyrë ka bërë shkeljet e pretenduara disiplinore. Në anën tjetër, përmbauesja private thekson se lënda është inicuar në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm C.nr.3295/12, i datës 13.07.2016, e me të cilin Gjykata kishte aprovuar kërkesë padinë e paditësit: *Banka Raiffaisen*. Pala e paditur- Raiffaisen bank ishte detyruar që paditësit t'i kompensoj në emër të kamates shumë e caktuar si për mjetet e deponuara për një vit pa destinim për periudhën 28.01.2008 e deri 12.11.2008. Sipas përmbaueses private, padia nuk ka qenë nga kontesti i marrëdhënies së punës siç pretendohet, por e njëjta ka të bëjë me borgjin rrjedhimisht kompenzimin e kamatës së pa paguar të borgjit kryesor të cilin ka paguar.

Komisioni Disiplinor gjen me vend të thekson se lidhur me çështjen nëse përmbauesja private kishte apo jo kompetencë, ka pasur një kontroll gjyqësor nga gjykata kompetente lidhur me urdhërin përmbaimitor objekt i shqyrtimit. Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr 526/16 të dt 30.09.2016 e ka refuzuar prapësimin e debitorit- Institucionit Financiar *Banka Raiffaisen*, duke lënë në fuqi urdhërin për lejimin e përmbaimit. Komisioni Disiplinor rithekson se bazuar në faktin se çështja e kompetencës lëndore vlerësohet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*), rezulton se gjykata në fjalë ka mbajtur qëndrimin se ekzekutimi i aktgjykimit C. nr 3295/12 bie pikërisht në kompetencës e përmbaueses private dhe se nuk është krijuar ndonjë praktikë gjyqësore që për rastet e tilla apo të ngjajshme, procedura përmbaimore të zhvillohet nga gjykata. Pala ankuese kishte ushtruar mjetet juridike dhe gjykata ka vendosur se urdhëri përmbaimitor ishte i rregullt. Gjithashtu ishte refuzuar kërkesa për përjashtimin e përmbaueses private nga kjo çështje përmbaimore. Po ashtu edhe gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesën e paraqitur nga ana e palës ankuese si të pabazuar. Rrjedhimisht çështja e kompetencës së përmbaueses private është trajtuar në gjykatë. Komisioni Disiplinor nuk është i thirrur që të vlerësojë ato vendime. Me fjalë të tjera, procedura disiplinore nuk është instancë tjetër gjyqësore ose zëvendësuese e organeve gjyqësore, ku palët mund të adresojnë përsëri kërkesat e tyre të natyrës juridike, të cilat ata tashmë i kanë ngritur ose mund të kishin ngritur me mjetet e përcaktuara ligjore nëpër gjykata.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
DPL.nr 16/2017, datë 25.01.2021



Kryesues i Komisionit Disiplinor  
Adnan ISUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.